



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPSTINA LIPJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 19 paragrafi 3. të Ligjit Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 85/2010, nenit 12 par.12.2 dhe nenit 17 pika e) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008) dhe nenit 20 pika d) të Statutit të Komunës së Lipjanit Nr.110-78095 të datës 24.12.2021 Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 31.03.2022, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

V E N D I M

PËR MBROJTJEN E VLERËS SË NATYRËS: "TRUNGU I QARRIT (*QUERCUS CERRIS*)" NË FSHATIN RESINOC SI MONUMENT I NATYRËS

1. Me këtë vendim merret nën mbrojtje vlera e natyrës "**Trungu i Qarrit (*Quercus cerris*)**", në fshatin Resinoc të Lipjanit, si Monument i Natyrës i karakterit botanik (këtu e tutje: Monumenti i Natyrës).
 - 1.1. Monumenti i Natyrës me hapësirën përfshirëse rreth projeksonit të kurorës prej 10 metra përfshinë sipërfaqen prej **5 ari**.
 - 1.2. Monumenti i Natyrës ka pamje karakteristike të kurorës, vjetërsi dhe vlera të tjera natyrore dhe si i tillë është i rrallë jo vetëm për territorin e komunës së Lipjanit por edhe më gjerë.
 - 1.3. Lartësia e kërcellit të Monumentit Natyror është rreth 18 – 20 metra, perimetri i kërcellit është 2.5 metra, diametri i kurorës 14 metra dhe vjetërsia është mbi 150 – 200 vite.
2. Monumenti i Natyrës gjendet në oborrin e shkollës së fshatit, në pronë shoqërore, në parcelën 01017-2, zona kadastrale Resinoc, nr. P-71409073-01017-2, me sipërfaqe 1470 m², e regjistruar si pronë shoqërore.
3. Monumenti i Natyrës sipas IUCN-it kategorizohet si vlerë e natyrës e kategorisë së III-të, Natural Monument/Natural Landmark – Monument i Natyrës.
4. Për Monumentin e Natyrës përcaktohet regjimi i mbrojtës i shkallës së III-të, në të cilën përcaktohen masat dhe kushtet vijuese me të cilat në Monumentin e Natyrës ndalohej:
 - 4.1. Prerja e trungut, thyerja e degëve, mbledhja e gjetheve apo fryteve, kositja e barit si dhe çfarëdo veprimtarie e cila ndryshon gjendjen e tanishme;
 - 4.2. Ndezja e zjarrit në sipërfaqen e mbrojtur;
 - 4.3. Mbjellja e bimëve me qëllim të gjelbërimit të sipërfaqes së mbrojtur;

- 4.4. Ndryshimi i pamjes së sipërfaqen së mbrojtur;
- 4.5. Grumbullimi i mbeturinave në sipërfaqen e mbrojtur;
- 4.6. Aktivitetet të tjera të cilat mund të shkaktojnë ndryshime ose dëmtime të Monumentit të Natyrës;
- 4.7. Lëshimi i ujërave të ndotura, deponimi i mbeturinave dhe mbetjeve të tjera;
- 4.8. Përdorimi i mjeteve mbrojtëse kimike;
- 4.9. Ndërrimi i kulturës;
- 4.10. Mbjellja e bimëve ose ngritja e objekteve të cilat mund të ndikojnë në pengimin e pamjes së Monumentit Natyror.

5. Monumenti i Natyrës dhe hapësira rrethuese mund të rregullohet dhe të shfrytëzohet për qëllime të prezantimit me kusht që destinimet e reja nuk e rrezikojnë Monumentin e Natyrës.
 - 5.1. Në Monumentin e Natyrës lejohen të gjitha masat e mbrojtjes biologjike-teknike të Monumentit Natyror nën kushtet të cilat i përcakton Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe në bazë të projektit për sanimin e gjendjes së Monumentit Natyror si dhe punët teknike të cilat janë në funksion të mbrojtjes të Monumentit Natyror.

6. Për zbatimin e masave dhe kushteve të përcaktuara, kujdeset komuna e Lipjanit, përmes drejtorisë përkatëse.

6.1. Komuna është e detyruar që:

- 6.1.1. Monumentin e Natyrës ta mbroj, ta ruaj dhe mirëmbajë në pajtim me kushtet e përcaktuara të mbrojtjes
- 6.1.2. Në rast të paraqitjes së ndryshimeve të cilat Monumentin e Natyrës mund ta shkatërrojnë ose t'i dëmtojnë vetit e rëndësishme të tij, menjëherë të lajmëroj Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës
- 6.1.3. Të bëjë shënjimin e kufijve të Monumentit Natyror në pajtim me Rregulloren për shënjimin e zonave të mbrojtura

7. Planet hapësinore dhe urbanistike, projektet, bazat ekonomike-pyjore, hidro-teknike duhet të harmonizohen me masat dhe kushtet për mbrojtjen e Monumentit Natyror


8. Vendimi shpallet pesëmbëdhjetë (15-të) ditë pas regjistrimit në zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe hyn në fuqi shtatë (7-të) ditë pas publikimit në gjuhën zyrtare dhe në web-faqen zyrtare të komunës së Lipjanit.

Nr. 15-352/01-17301

Lipjan, më 31.03.2022

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN





Harta e Monumentit Natyror “Trungu i Qarrit (*Quercus cerris*)”, në Resinoc